



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 766/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Agon Ramadani – Kryetar, Kimete Gashi – Anëtare dhe Vedat Potërçoi – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Instituti i Shkencës dhe i Teknologjisë “INSI” sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mbështetje e komunës ne përgatitje të PZHK për vitet 2023-2031 Ritender” me numër të prokurimit: 634-22-12030-2-2-1, iniciuar nga (AK)– Kuvendi Komunal i Klinës, me datën 10.03.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. Anullohet në tërësi, aktiviteti i prokurimit me titull: “Mbështetje e komunës ne përgatitje të PZHK për vitet 2023-2031 Ritender” me numër të prokurimit: 634-22-12030-2-2-1, iniciuar nga Kuvendi Komunal i Klinës.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj Panelin Shqyrtues të OSHP, për gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi. Në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa ndaj AK për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

III. Me qenë se aktiviteti i prokurimit është anuluar në tërësi, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, ndërsa i lejohet operatorit ekonomik ankues që, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 30.11.2022, Komuna e Klinës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për Dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Mbështetje e komunës në përgatitje të PZHK për vitet 2023-2031 Ritender” me numër të prokurimit: 634-22-12030-2-2-1, ku është rekomanduar për kontratë OE Grupi i Operatorëve Ekonomik “Kolegji për Biznes dhe Teknologji” & “UBT-data Gisconsulting sh.p.k” me seli në Prishtinë.

Me datë 05.12.2022, Operatori Ekonomik “INSI” sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Klinës, me datë 07.12.2022, AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 30.11.2022. Me datën 15.12.2022 Operatori Ekonomik “INSI” sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 766/2022, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar “Shërbime” Procedurë e hapur vlera e parashikuar e kontratës: 40,000.00 €. Kriteri për dhënien e kontratës- çmimi më i ulët.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 06 janar 2023 me raportin e ekspertizës. Me datë 13 janar 2023 AK Komuna e Klinës ka deklaruar se nuk pajtohem me mendimin e ekspertit shqyrtues. Me datë 10 janar 2023 OE “INSI” sh.p.k, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 27.12.2022, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “INSI” sh.p.k të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 30.11.2022 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

-Seanca dëgjimore

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa me datë 09.03.2022 është ftuar eksperti shqyrtues që për panelin shqyrtues të ofrojë sqarime rreth kërkesave në DT dhe NJK, ku përgjatë seancës shqyrtuese eksperti shqyrtues teknik pas analizimit dhe shqyrtimit të ekspertizës së tij në relacion me pretendimet ankimore ka deklaruar se kriteret përmbajnë paqartësi në aspektin se vitet e përvojës së punës cilëve ekspertë/inxhinierë të kërkuar ju referohen.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton;

Deri tek vendimmarrja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi si çështje përcaktuese kryesore u konsideruan pikat të cilat PSH i konsideroi si kyçe që rrjedhimisht dërguan deri tek anulimi i tërësishëm i këtij aktiviteti të prokurimit ishin: përpilimi të dojes së tenderit, përkatësisht kriterëve kualifikuese, konkretisht paqartësia dhe mundësia e interpretimeve të ndryshme të këtyre kërkesave që rrjedhimisht pamundësuan vendim-marrjen meritore lidhur me këtë aktivitet prokurimi.

Lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues të paraqitura në ankësë kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, Paneli Shqyrtues konstaton se nuk ka qenë e mundur që ankesa të trajtohet në mënyrë meritore duke qenë se kemi pasur të bëjmë me dosje jo të përpiluar qartë, në të cilën ka pasur lëshime në aspektin e përpilimit dhe specifikimit nga ana e AK, andaj Paneli Shqyrtues konstatoi se zgjidhja më e mirë në këtë rast do të ishte anulimi i tërësishëm i këtij aktiviteti, si dhe në rast se AK ka interes që ta ri-tenderoj, obligohet që lëshimet të cilat do të shtjellohen si më poshtë ti përmirësoj, kështu duke mundësuar mundësi të barabartë për të gjithë ofertuesit e interesuar e gjithashtu duke devijuar mundësinë e diskriminimit të tyre në të ardhmen duke pasur parasysh qëllimin e kontratës.

Kërkesa me numër 7 në DT ka qenë kërkesa lidhur me stafin profesional si në vijim:

“KERKESA 7. Staf

- a) Një ekspert i Planifikimit Hapësinor – së paku MSc. në fushën e Planifikimit Hapësinor dhe Urban) i cili do të jetë caktuar edhe si MENAGJER për këtë projekt.
- b) Një ekspert i Planifikimit Hapësinor dhe Urban - së paku me gradë shkencore MSc.
- c) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Arkitektures
- d) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Ndërtimitarisë drejtimi Konstruktiv
- e) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Ndërtimitarisë drejtimi Hidroteknike
- f) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Elektroteknikes
- g) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Komunikacionit
- h) Një inxhinier apo MSc i diplomuar i Bujqësisë
- i) Një Ekonomist, së paku me gradë shkencore MSc.
- j) Një person të certifikuar për aplikimin e sistemit GIS, së paku 10 vjet përvojë pune me Sisteme të informacioni - GIS (specifike në hartimin e planeve Zhvillimore, Hartave Zonale, apo dokumenteve të Fizibilitetit - Strategjive Zhvillimore, etj.
- k) Një person i certifikuar për vlersimin e ndikimit në mjedis.

Stafi i kërkuar duhet të ketë së paku 5 (pese vjet) përvojë pune profesionale në fushën e planifikimit hapësinor.

- l) Një ekspert i trashigimisë kulturore, së paku me gradë shkencore MSc. Staf i kërkuar duhet të ketë së paku 5 (pese vjet) përvojë pune profesionale ose akademike-shkencore në fushën e trashigimisë kulturore.
- m) Një Gjeograf - Demograf (MSc) i demografisë) të jetë i angazhuar edhe si menagjer për këtë projekt.”

OE ankues në ankesën e tij, në këtë rast ka paraqitur pretendime lidhur me shumicën e stafit të paraqitur nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, me pretendimin se ata nuk përmbushin kërkesën që “Stafi i kërkuar duhet të ketë së paku 5 (pese vjet) përvojë pune profesionale në fushën e planifikimit hapësinor.”, kërkesën për rishqyrtim AK e ka refuzuar me arsyetimin: Sipas DT neni 9.1 & 9.2 - përvoja e punës (5 vite) nuk kërkohet për pikat a) deri në i) dhe pikën m). Ndërsa për pikat: j) kërkohet 10 vjet përvojë pune, pikën k) 5 vjet përvojë pune, dhe pikën l) 5 vjet përvojë pune.”, gjë që nuk është specifikuar në kërkesën e sipërpërmendur fare por është paraqitur si arsyetim në faza të mëvonshme, që në këtë rast PSH konsideron se kjo situatë ka krijuar paqartësi e për më tepër mund të konsiderohet si ndryshim apo interpretim i ndryshëm përgjatë fazave të rivlerësimit, gjë që bie ndesh me legjislacionin në fuqi e po-ashtu me tiparet themelore të LPP-së, kështu duke krijuar hapësirën e diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomik, andaj PSH konsideroi se kërkesa e tillë (vitet e përvojës së kërkuara për stafin), e paspecifikuar se kujt i referohet me rastin e publikimit të NJK dhe DT, ka qenë kërkesë

e paqartë, andaj rrjedhimisht ka qenë e pamundur që të arrihet deri tek vendimi përfundimtar lidhur me pretendimet ankimore.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u thanë si më sipër, PSH konstaton se hartimi i kësaj Dosje të tenderit ka qenë në kundërshtim me nenin 27 të LPP-së, paragrafi 1, e posaçërisht duke u mbështetur në nenin 47.14 i RRUOPP-së, i cili citon: "Autoriteti kontraktues duhet të marrë një qasje të ngjashme jo-kufizuese kur zbulon se dosja e tenderit që ka lëshuar mund të ketë mangësi të caktuara ose mund të jetë më pak e qartë në disa pika. Kjo megjithatë nuk duhet që në asnjë rrethanë të çojë në ndonjë ndryshim de facto në kërkesat teknike dhe të tjera të dosjes së tenderit. Nëse autoriteti kontraktues vjen në përfundimin se tenderi i planifikuar është në fakt i papërshtatshëm atëherë ajo nuk do të jetë e mundur për të "riparuar" në dosjen e tenderit me anë të informacionit shtesë ose sqarime. Qasja e vetme në dispozicion në situata të tilla është që të anulohet tenderin dhe të fillojë një procedurë tjetër në bazë të një dosjeje të tenderit të ndryshuar."

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkojë ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është arritur duke u bazuar nga fakti se anulimi i këtij aktiviteti është arritur si shkak i mos-respektimit të legjislacionin në fuqi nga ana e AK-së.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Klinës

1x1 OE "INSI" sh.p.k me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.